



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:032370
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05797875

P.nr.167/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gylaj Nepola, në çështjen penale kundër të pandehurit X. F nga fshati K, komuna P, për shkak të veprës penale „Lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 par.3 nën par.3.1, lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm nën shenjën PP/II.nr.143/21, të dt.19.02.2021, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit fillestar të mbyllur për publikun, me datë 27.04.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore në Pejë, Ermal Demhasaj, të pandehurit Xh.F, mbrojtësit të tij av.Taulant Baloku dhe përfaqësueses ligjore të dëmtuarit - të miturit K.V, nëna e tij S.Sh me datë 29.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 29.05.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

XH. F i lindur më datë, në K, komuna P, ku edhe banon, i biri i A dhe nënës Z e vajzërisë M, ka te kryer shkollën, me profesion, i, baba i i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit të lëshuar nga MPB të Republikës së Kosovës me nr. personal, tel....., i pa dënuar më parë nga gjykata, shqiptar, shtetas i RKS-së, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse, me datë, rreth orës, në Pejë rr. “B.L”, përkatësisht pranë furrës së bukës “.....”, tjetrit i shkakton lëndime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme në shëndet dhe atë të dëmtuarit të mitur K.V, në atë mënyrë që, ditën kritike derisa këtu i dëmtuari shkon në furrën në fjalë për të blerë samun (pitalkë) dhe pasi e vëren se samuni ishte i ftohtë e kërkon një tjetër të nxehtë ku këtu i pandehuri(furrtar)i thotë se duhet pritur pak, i dëmtuari i revoltuar e copëton dhe e gjuan të tokë samunin, i pandehuri e merr një fshesë për ta frikësuar dhe me të njëjtën e godet të dëmtuarin, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndet.

- me çka ka kryer vepër penale,, Lëndim i lehtë trupor ” nga neni 185 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 nën par 1.4 të KPRK-së.

Andaj, konform nenet 7, 38, 39, 40, 42, 44, 69, 70, neni 184 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së dhe neni 364, 365, 452 par.1, neni 462 par.2 të KPPRK-së, gjykata të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME BURGIM

Ashtu që i përcakton:

I.Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **150 (njëqind e pesëdhjetë) ditësh**, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit, **konform neni 44 të KPRK-së, i është zëvendësuar me:**

DËNIM ME GJOBË - shumë në lartësi prej **pesëmijë (1000) euro**, të cilin dënim i pandehuri detyrohet që ta paguaj në afat prej **90 (nëntëdhjetë) ditësh**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata konform neni 43 paragrafi 3 i KPRK-së mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ku 20 € (njëzet euro) gjobë llogaritet barabartë me 1 (një) ditë burgim.

III.I pandehurit obligohet gjykatës t’ia paguajnë shpenzimet e procedurës dhe atë paushallin gjyqësor shumë prej **20 € (njëzetë euro)** në afat prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditësh**, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, **nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.**

IV.I pandehurit obligohet ta paguajnë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej **20 € (njëzetë euro)**, në afat prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditësh** pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, **nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.**

V.Pala e dëmtuar i mituri K.V, me përfaqësuesen e tij ligjore-nënë S.Sh, me adresë banimi në fsh K K. Pejë (me vendqëndrim në Gj) për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë nën shenjën PP/II.nr.143/21, të dt.19.02.2021, kundër të pandehurit Xh. F nga fshati K, komuna P, për shkak se ekziston dyshimi i bazuar mirë se ka kryer vepër penale „Lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 nën par 1.4 të KPRK-së.

Konform neni 240 të KPPRK-së gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 27.04.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore në Pejë, Ermal

Demhasaj, të pandehurit Xh.F, mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare av. Taulant Baloku dhe përfaqësues ligjore të të dëmtuarit-fëmijës K.V., nënës së tij S.Sh

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par.1 të KPPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurin në të drejtat e tij.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit , gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe duke vepruar në kuptim të nenit 241 par.4 të KPPRK-se , të pandehurit i është dhënë mundësia që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë.

I pandehuri i vetëdijshëm për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pas konsultimit me mbrojtësit e tij, deklaroi se vullnetarisht me vetëdije të plotë dhe pa kurrfarë presioni e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë pasi që pranimi është bërë në mënyrë vullnetare pa presion dhe ka mbështetje në shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të pandehurit deklaroi se pajtohet me deklaratën e të mbrojturit të tij për pranimin e fajësisë pasi pranimin e fajësisë e ka bërë pas një konsultimi të mjaftueshëm dhe pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, me ç'rast i propozoi gjykatës që pranimin e fajësisë të aprovoj.

Gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, pas dëgjimit të palëve të cilën u pajtuan me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, e ka miratuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi është bindur se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 242 par. 2, nën par. 2.1, 2.3, 2.4 të KPPRK-së, pasi që i pandehuri e kuptoj natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në provat personale dhe materiale nga shkresat e lëndës respektivisht aktakuza siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2020-DA-0761 datës 21.05.2020; Raporti i policit rr. Faton Berisha #7195, i datës 21.05.2020; Procesverbal mbi intervistimin e të dëmtuarit K.V i datës 21.05.2020; procesverbal mbi intervistimin e të dyshuarit Xh,F, i datës 21.05.2020; raporti mjekësor i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm –Pejë i datës 21.05.2020; akt - ekspretim mjeko ligjor i datës 03.02.2021, pastaj dhe pasi aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik.

Prokurori i shtetit me rastin e matjes së dënimit gjykatës i propozoi që në kontekst të rrethanave lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethanë rënduese ndonjë dënim eventual të mëparshëm.

Mbrojtësi i të pandehurit , mes tjerash deklaroi se meqenëse në këtë çështje penale i mbrojturi i tij e ka pranuar fajësinë për veprën e kryer penale e cila i vihet në barrë duke i kërkuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit ti ketë parasysh rrethanat lehtësuese si janë: pranimi e fajësisë, pendimin edhe keqardhjen, nivelin e dashjes, kërkim faljen, gjendjen ekonomike pasi është mbajtësi i vetëm i familjes, dhe me rastin e shqiptimit të dënimit të mbrojturit të tij ti shqiptohet dënim më i butë .

I pandehuri deklaroi se pajtohet me deklaratën e mbrojtësit së tij, kërkoi falje të dëmtuarit dhe familjes së tij dhe shprehi keqardhje.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar edhe në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit Xh. F, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale,, Lëndim i lehtë trupor ” nga neni 185 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, dhe nuk ka rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit ngase i njëjti është e vetëdijshëm për veprën e kryer penale e ka kryer me dashje prandaj është penalisht përgjegjës.

Gjykata, duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata morri parasysh pranimin e fajësisë, kërkim faljen, faktin se është hera e parë që bie ndesh me ligjin, fakti se me palën e dëmtuar nuk ka pasur probleme më, ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata pati parasysh faktin se vepra penale është kryer ndaj viktimës së ndjeshme, saktësisht fëmijës të moshës.... vjeçare.

Sa i përket dënimit të shqiptuar të pandehurit, gjykata në rastin konkret, pas parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të njëjtit si rrethane posaçërisht lehtësuese, ka aplikuar nenin 71 dhe 72 të KPRK-së dhe të njëjtit i ka shqiptuar dënimin nën minimumin e paraparë ligjor, konform nenit 72 par. 1 nën par. 1.6 të KPRK-së ku parashihet së “ nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim me më pak se një (1) vit, dënimi mund të zbutet deri në tridhjetë (30) ditë burgim;”, ashtu që fillimisht i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditë, dhe njëkohësisht në kuptim të nenit 44 par. 1 dhe 2 të KPRK-së i ka dhënë mundësinë që ky dënim të zëvendësohet me dënim me gjobë, ashtu që i njëjti përmes mbrojtësit së tij përmes parashtresës kanë dhënë pëlqim që dënimi i shqiptuar me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe të njëjtit ia zëvendësoi dënimin me burgim në dënim me gjobë.

Andaj, gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit, e që është pengimi i të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për zëvendësimin eventual e dënimit të shqiptuar me gjobe me dënim burgimi në rast se i pandehuri dështon apo refuzon ta paguan dënimin me gjobë u morr konform nenit 43 par. 3 dhe 4 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6, nenin 450, 452 paragrafi 1 të KPP-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3, nën

paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimin, në të cilat të pandehurit obligohen t'i paguajnë brenda afatit të përcaktuar si më lartë, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Konform nenit 462 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarën, gjykata e udhëzoi në kontest juridiko civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal
P.nr.167/21, me datë 29.05.2024.

Bashkëpunëtore profesionale

Gjyqtare e vetme gjykuese

Gylaj Nepola

Ilda Cucović Sahatçiu

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.